



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NDËRMARRJA E PASTRIMIT**

PROCES-VERBAL

PËR

**"KONSULTIMIN PUBLIK PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT
TË INTEGRUAR TË MBETJEVE URBANE, BASHKIA KAMËZ, PRANË
AMBIENTEVE TË PALLATIT TË KULTURËS"**

I mbajtur sot më **18.03.2025**, ora **16:00** pranë ambienteve të pallatit të kulturës, për konsultimin publik për miratimin e "Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane", sipas njoftimit të Bashkisë Kamëz.

Takimi filloi me prezantimin e planit në disa pika përmbledhëse ku Plani Lokal i Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/udhëzues i rëndësishëm për manaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz.

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për manaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. PLMIMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Të pranishmit në këtë konsultim shtruan diskutime në lidhje me :

- i) Shërbimi i pastrimit të rrugëve;
- ii) Shërbimi i grumbullimit, transportit i mbetjeve;
- iii) Depozitimi i mbetjeve në landfillin e Sharrës;
- iv) Shërbimi i minimizimit të mbetjeve.